

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 579 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

**VENDIM Nr. 41, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA),

**VENDOSI:**

1. Të mos miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), pasi më parë duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e strukturave të gjetura nga gërmimet e mëparëshme. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

